

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



Korrik 2021

Raport i Ndërmjetëm Vlerësimi
janar-qershor 2021

Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Raport i Ndërmjetëm Vlerësimi:

Janar - Qershor 2021

Autorë

Arjan DYRMISHI
Mirsada HALLUNAJ



Ky raport u përgatit nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “Mbështetja e zbatimit të reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme”, i mbështetur nga Programi i Reformës në Drejtësi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Përmbajtja

Gjetje kryesore	1
Metodologjia Analiza dhe të dhënat	7
Hyrje Vlerësime dhe Rekomandime	10
DIMENSIONI I Produktiviteti	13
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKKO	14
Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKKO	16
DIMENSIONI II Efiçenca	19
Çështje të korrupsionit	21
Çështje të krimit të organizuar	21
DIMENSIONI III Relevanca	22
Çështje të korrupsionit, Veprat penale dhe Subjektet	23
Çështje të korrupsionit, Masat e dënimit	24
Çështje të krimit të organizuar, Veprat penale dhe Personat e përfshirë	25
Çështje të tjera penale	27
ANEKS A	28

Gjetje kryesore:



DIMENSIONI I: PRODUKTIVITETI

Statusi i çështjeve (Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKKO)

	Çështje mbartura nga vitit 2020	Çështje të përfunduara nga viti 2020	Çështje në proces nga viti 2020	Çështje të reja të regjistruara 2021	Çështje të përfunduara nga viti 2021	Çështje në proces nga viti 2021	
Çështje të korrupsionit	18	14	4	3	2	1	<ul style="list-style-type: none"> ■ Çështje mbartura nga vitit 2020 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2020 ■ Çështje në proces të nga viti 2020 ■ Çështje të reja të regjistruara 2021 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2021 ■ Çështje në proces nga viti 2021
Çështje të krimit të organizuar	34	13	21	12	1	11	<ul style="list-style-type: none"> ■ Çështje mbartura nga vitit 2020 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2020 ■ Çështje në proces të nga viti 2020 ■ Çështje të reja të regjistruara 2021 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2021 ■ Çështje në proces nga viti 2021
TOTALI I ÇËSHTJEVE	52	27	25	15	3	12	

DIMENSIONI I: PRODUKTIVITETI



Statusi i çështjeve (Gjykata e Posaçme e Apelit KKKO)

	Çështje mbartura nga vitit 2020	Çështje të përfunduara nga viti 2020	Çështje në proces nga viti 2020	Çështje të reja të regjistruara 2021	Çështje të përfunduara nga viti 2021	Çështje në proces nga viti 2021	
Çështje të korrupsionit	1	0	1	15	3	12	<ul style="list-style-type: none"> ■ Çështje mbartura nga vitit 2020 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2020 ■ Çështje në proces të nga viti 2020 ■ Çështje të reja të regjistruara 2021 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2021 ■ Çështje në proces nga viti 2021
Çështje të krimit të organizuar	2	0	2	11	0	11	<ul style="list-style-type: none"> ■ Çështje mbartura nga vitit 2020 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2020 ■ Çështje në proces të nga viti 2020 ■ Çështje të reja të regjistruara 2021 ■ Çështje të përfunduara nga viti 2021 ■ Çështje në proces nga viti 2021
TOTALI I ÇËSHTJEVE	3	0	3	26	3	23	

DIMENSIONI II: EFIÇENCA

Kohëzgjatja e çështjeve

	Vendime në TOTAL	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet
Çështje të korrupsionit						
	26	5	7	0	0	0
Çështje të krimit të organizuar						
	14	0	0	6	2	2
Çështje të korrupsionit (Viti 2020)	14	3	9	2	0	0
Çështje të korrupsionit (Viti 2021)	12	5	7	0	0	0
Çështje të krimit të organizuar (Viti 2020)	13	0	0	6	2	2
Çështje të krimit të organizuar (Viti 2021)	1	0	1	0	0	0



DIMENSIONI III: Relevanca		
Numri i veprave penale të regjistruara për korrupsion		
Çështje të korrupsionit	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	17
	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	13
	Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë	/
	Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë	/
	Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor	/
	Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendor	/
	Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit	/
	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	/
	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	/
	Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj	/
	Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	1
	Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	/
	Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare	/
	Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj	/
	Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja	/
	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	/
	Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtim ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	2
	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	5
	Përfitimi i paligjshëm i interesave	/
	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	1
Masat e dënimit për vepra penale të korrupsionit (numri i të pandehurve)		
Dënim me burgim	5	
Pezullimi i ekzekutimit të vendimit	20	
Heqja e të drejtës për të ushtruar funksione publike	3	

DIMENSIONI III: RELEVANCA											
Të pandehur për vepra në kuadër të organizatave kriminale											
Çështje të kimit të organizuar	Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale	Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	Organizata kriminale	Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale	Grupi i strukturuar kriminal	Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale	Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal / Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm	
	1	/	1	/	2	6	7	3	7	/	
	Veprat kryesore penale			Veprimtaritë kryesore kriminale				Modus Operandi			
	Vepra penale në fushën e narkotikëve Organizata kriminale			Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve				Vrasja Vjedhja			

Metodologjia: Analiza dhe të dhënat



Ky raport i ndërmjetëm vlerësimi trajton ecurinë e çështjeve në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar të hetuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe ato të regjistruara në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjatë periudhës 1 janar-30 qershor 2021.

Vlerësimi i 29 çështjeve për korrupsionin dhe 12 për krimin e organizuar të trajtuara në këtë raport të ndërmjetëm monitorimi dhe vlerësimi, bazohet në metodologjinë e hartuar në Raportin e Vlerësimit “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2020”,¹ e cila konsiston në dy faza kryesore: (i) Monitorimin e çështjeve dhe mbledhjen e informacionit/të dhënave dhe (ii) Analizimin e të dhënave/çështjeve në përputhje me indikatorët e përcaktuar në metodologji, të cilët lidhen me 3 dimensione kryesore si produktiviteti, eficientia dhe relevanca.

1. Dimensio­ni i **produktivitetit** fokusohet në vlerësimin e numrit të rasteve të iniciuara në baza vjetore si dhe statusin e tyre aktual;
2. Dimensio­ni i **efiçensës** fokusohet në vlerësimin e kohëzgjatjes së çështjeve sipas kalendarit kohor të gjykatave dhe kohëzgjatjes mesatare të çështjes;
3. Dimensio­ni i **relevancës** fokusohet në vlerësimin e çështjeve në përputhje me kompleksitetin dhe rëndësinë.

Kjo metodologji synon që përveç vlerësimit të çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të shërbejë për kryerjen e një monitorimi të vazhdueshëm dhe sistematik në funksion të identifikimit të zhvillimeve, të cilat lidhen me përmirësimin e politikave penale në luftën kundër këtyre fenomeneve.

Për hartimin e këtij raporti të ndërmjetëm vlerësimi, mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet informacionit të publikuar nga institucionet respektive: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)² dhe Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.³

Baza e të dhënave me informacionin respektiv për çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, e krijuar fillimisht në funksion të hartimit të Raportit të Vlerësimit është përditësuar me të dhënat që i përkasin 6-mujorit të parë të vitit 2021, ndër­kohë që vlerësimi dhe analiza e të dhënave për çështjet është kryer bazuar në metoda sasiore dhe cilësore.

Ky raport monitorimi dhe vlerësimi mbulon vetëm 6-mujorin e parë të vitit 2021. Analiza e 30 vendimeve të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021, të cilat i përkasin çështjeve të regjistruara në vitin 2020 do të reflektohet në Raportin e Vlerësimit për vitin 2020.

Grupi i punës së projektit falenderon gjithashtu Kancelarët dhe stafin mbështetës të Gjykatave të Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për mbështetjen e ofruar në marrjen e informacionit dhe të dhënave.

¹ Dyrmishi.A, Hallunaj.M, Raport Vlerësimi “Veprimtaria e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar 2020”. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Shkurt 2021: Link-u i publikimit: http://csdgalbania.org/sq/ep-content/uploads/2021/03/Raport-Vleresimi_SPAK-Gjykatat-2020-FINAL-1.pdf

² Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Faqe ëeb: <https://spak.al/>

³ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Faqe ëeb: <https://ëëë.gjp.gov.al/>
Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Faqe ëeb: <http://ëëë.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/>

Lloji i veprave penale	PRODUKTIVITETI			EFIÇENCA					RELEVANCA	
	Statusi i çështjeve			Kohëzgjatja e procesit gjyqësor					Statusi i subjekteve të akuzuar/dënuar	Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale
Çështje të korrupsionit	Çështje të regjistruara	Çështje në proces	Çështje të përfunduara	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet	Funksionarë të lartë shtetërorë ose të zgjedhur vendorë	Vlera ekonomike (humbja) më shumë se 1 milion Euro
									Gjyqtarë, prokurorë dhe funksionarë të tjerë të drejtësisë	Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 400 mijë Euro dhe 1 milion Euro.
									Persona që ushtrojnë funksione publike	Vlera ekonomike (humbja) ndërmjet 100 deri 400 mijë Euro
Çështje të krimit të organizuar	Statusi i çështjeve			Kohëzgjatja e procesit gjyqësor					Kompleksiteti i krimit	Niveli i pasojës që rezulton nga sjellja kriminale
	Çështje të regjistruara	Çështje në proces	Çështje të përfunduara	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet	Veprat kryesore penale	Vlera e aktiviteteve të paligjshme të përfshira
									Numri i personave të përfshirë ⁴	Veprimtaria/veprimet themelore kriminale të ndërmarra
									Zona gjeografike e veprimit (veprimtari transnacionale e krimit të organizuar) ⁵	Mënyra e veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar


Tabela 1: Indikatorët e përdorur për të vlerësuar procedimet penale në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

⁴ - Numri i anëtarëve të grupit më shumë 10, **i Lartë**
- Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 5-10, **Mesatar**
- Numri i anëtarëve të grupit ndërmjet 3-5, **i Ulët**
⁵ Aktivitet, i cili përfshin **Shqipërinë dhe 1 vend tjetër**
- Aktivitet, i cili përfshin **Shqipërinë dhe 2 vende të tjera**
- Aktivitet, i cili përfshin **Shqipërinë dhe më shumë se 2 vende të tjera**

Hyrje:

Rekomandime dhe Vlerësime





Lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar është konsideruar ende si një nga problematikat kryesore të Shqipërisë në Raportet më të fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit për vitin 2020.

Përveçse një kërcënim serioz për ekonominë, luftën kundër varfërisë, demokracinë, politikën e jashtme, korrupsioni konsiderohet një kërcënim serioz edhe për sigurinë kombëtare.

Urdhri Ekzekutiv i lëshuar nga Presidenti i SHBA në qershor 2021 rikonfirmoi angazhimin në luftën kundër korrupsionit duke zgjeruar hartën dhe kriteret e vendosjes së sanksioneve ndaj individëve dhe organizatave që përfshihen në korrupsion dhe krim të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë.

Në vitin e dytë të veprimtarisë së tyre, Prokuroria dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vazhdojnë të funksionojnë në mungesë të kapaciteteve të plota, një sfidë kjo e shtuar në arritjen e objektivave konkretë të këtyre organeve.

Numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve të posaçëm vazhdon të mbetet i ulët kundrejt përcaktimeve ligjore, një problematikë kjo e theksuar edhe më shumë në rastin e Gjykatave të Posaçme ku identifikohet edhe një mungesë e theksuar për të aplikuar në pozicionet e shpallura vakante nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

Ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) është gjithashtu ende në proces të finalizimit, ndërkohë që emërimi i 28 kandidatëve të parë për hetues, të cilët përfunduan me sukses muajin e parë të trajnimit bazë shënoi një hap pozitiv në këtë drejtim.



Gjatë muajit shkurt 2021, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes publikoi Raportin e Vlerësimit mbi “Veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2020”.

Qëllimi kryesor i këtij raporti vlerësimi ishte identifikimi dhe analizimi i çështjeve dhe problematikave, të cilat ndikojnë në formulimin e një përgjigje efektive ndaj fenomeneve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri, me qëllim nxitjen e masave të duhura dhe të zbatueshme për adresimin e këtyre problematikave.

Raporti i cili u nda me institucionet respektive të përfshira në këtë proces monitorimi dhe vlerësimi, përfshiu gjithashtu adresimin e disa rekomandimeve në funksion të rritjes së transparencës së institucioneve, por edhe në kryerjen e një analize sa më të plotë dhe të saktë në drejtim të shqyrtimit gjyqësor të çështjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Vlerësojmë që angazhimi me institucionet respektive ka kontribuar pozitivisht në adresimin e disa problematikave, të cilat në mënyrë specifike lidhen me rritjen e transparencës dhe përditësimin sistematik të informacionit mbi dosjet penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ky Raport i Ndërmjetëm vlerësimi për periudhën janar-qershor 2021, i cili bazohet në metodologjinë e përcaktuar në Raportin e Vlerësimit ka si qëllim vijimin e monitorimit dhe analizës së çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në funksion të dy objektivave kryesorë:

1. Ndërtimin e mekanizmave të konsoliduar dhe efektivë me qëllim vlerësimin e performancës së institucioneve të reja të drejtësisë;

2. Përfshirjen dhe angazhimin e institucioneve me qëllim përmirësimin e vlerësimit dhe menaxhimit të performancës.



Në fillim të muajit prill 2021, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar publikoi raportin e parë vjetor mbi veprimtarinë e institucionit për vitin 2020. Ndërkohë që në mungesë të raporteve vjetore të plota, të dhëna mbi veprimtarinë e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjenden në raportin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) për vitin 2020.

Raportet e publikuara fokusohen kryesisht në pasqyrimin e të dhënave dhe analizave sasiore, të cilat reflektojnë informacion, i cili përqendrohet kryesisht vetëm në përshkrimin e rezultateve vjetore.

Në këtë kontekst, bazuar edhe në analizën dhe gjetjet e gjeneruara në këtë raport vlerësimi, konsiderohet se nevoja për të krijuar një model të mirëhartuar për të matur dhe vlerësuar performancën sipas një analize cilësore bazuar në të dhëna të harmonizuara dhe konsoliduara do të kontribuonte në dhënien e një vlerësimi sa më të plotë të performancës së institucioneve të hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, me qëllim përmirësimin e praktikave të raportimit nga këto institucione.

Dimensioni I: Produttiviteti



Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë KKKO

Çështje të mbartura nga viti 2020

Gjatë periudhës 1-vjeçare, 19 dhjetor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u regjistruan **70 çështje të reja penale**.

Së bashku me **26 dosje**, të cilat u transferuan në këtë gjykatë nga ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, numri total i çështjeve në këtë gjykatë shkoi në **96 çështje**.


Nga ky total çështjesh, 40 dosje penale i përkisnin veprave penale të korrupsionit, 50 krimin të organizuar dhe 6 dosje penale përfshinin vepra të tjera penale.⁶

Deri në 31 dhjetor 2020, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përfundoi gjykimi për **41 çështje**, duke sjellë një backlog prej **55 çështjesh** në vitin 2021.

Çështje të regjistruara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar në total **49 çështje të reja penale**, 29 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 12 në fushën e krimin të organizuar dhe 8 çështje të tjera të cilat përfshijnë vepra të tjera penale.

Muaji **janar 2021** rezulton të jetë muaji me numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara me 13 të tilla, ndjekur nga muajt shkurt dhe qershor 2021 gjatë të cilëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar respektivisht nga 9 çështje penale për muaj.



⁶ Në vepra të tjera penale përfshihen të gjitha akuzat penale që lidhen me subjektet e përcaktuara në legjislacion, për të cilat Prokuroria e Posaçme dhe Gjykatat e Posaçme ushtrojnë kompetencat.

Figura 1: Lloji dhe numri i çështjeve penale të mbartura dhe regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Vendime të dhëna nga Gjykatat e Posaçme e Shkallës së Parë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021


Gjatë periudhës janar-qershor 2021 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka dhënë në total **48 vendime**, **18 vendime** për çështje penale të regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021 dhe **30 vendime**, të cilat i përkasin 55 çështjeve penale të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020.

Vetëm 1 nga **18 vendimet** për çështjet e regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021, i përket 1 çështje në fushën e krimit të organizuar. Specifikisht 12 prej tyre janë çështje në fushën e korrupsionit, ndërkohë që 5 prej tyre përfshijnë vepra të tjera penale.

Në **30 vendimet** referuar çështjeve të regjistruara gjatë vitit 2020, përfshihen 14 vendime për çështjeve në fushën e korrupsionit, 13 të krimit të organizuar dhe 3 prej tyre përfshijnë vepra të tjera penale.

Deri në fund të muajit qershor 2021, nga 49 çështje në total për 6-mujorin e parë të vitit 2021, ka vazhduar gjykimi për **31 prej tyre**, 17 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 11 në fushën e krimit të organizuar dhe 3 prej tyre të lidhura me vepra të tjera penale.

Ndërkohë deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2021 kanë qenë në gjykim **25 çështje** nga 55 në total të cilat i përkasin vitit 2020, 4 për korrupsion dhe 21 për krim të organizuar.



Grafik 1: Ecuria e statusit të çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Gjykata e Posaçme e Apelit KKKO

Çështje të mbartura nga viti 2020

Gjatë periudhës 1-vjeçare, 19 dhjetor 2019 deri në 31 dhjetor 2020, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u regjistruan **17 çështje të reja penale**.

Së bashku me **11 dosje**, të cilat u transferuan në këtë gjykatë nga ish-Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, numri total i çështjeve në këtë gjykatë shkoi në **28 çështje**.

Nga ky total çështjesh, 2 dosje penale i përkisnin veprave penale të korrupsionit, 17 krimet të organizuar dhe 9 dosje penale përfshinin vepra të tjera penale.⁷

Deri në 31 dhjetor 2020, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përfundoi gjykimi për **22 çështje**, duke sjellë një backlog prej **6 çështjesh** në vitin 2021.




Figura 2: Lloji dhe numri i çështjeve penale të mbartura dhe regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Apelit KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

⁷ Në vepra të tjera penale përfshihen të gjitha akuzat penale që lidhen me subjektet e përcaktuara në legjislacion, për të cilat Prokuroria e Posaçme dhe Gjykatat e Posaçme ushtrojnë kompetencat.

Çështje të regjistruara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar në total **15 çështje të reja penale**, 3 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 11 në fushën e krimit të organizuar dhe vetëm 1 çështje e cila përfshin vepra të tjera penale.

Siç evidentohet edhe nga grafiku më poshtë, raporti i llojit të çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë është i ndryshëm nga çështjet e regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, në të cilën numri i çështjeve për korrupsion është më i lartë krahasimisht me veprat penale të përfshira në çështjet e tjera të regjistruara.

Vendime të dhëna nga Gjykatat e Posaçme e Apelit gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021


Nga 15 çështje të regjistruara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021, Gjykata e Posaçme e Apelit ka shpallur gjatë kësaj periudhe vendim për **3 të tilla**, duke lënë në fuqi 2 vendime të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe ndryshuar masat e dënimit për 2 të pandehur në 1 vendim për akuza penale të korrupsionit.⁸

Të 3 vendimet e dhëna nga Gjykata e Posaçme e Apelit gjatë kësaj periudhe i përkasin çështjeve të regjistruara gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021.

Deri në fund të muajit qershor 2021, nga 15 çështje në total për 6-mujorin e parë të vitit 2021, ka vazhduar gjykimi për **12 prej tyre**, 1 në fushën e korrupsionit, 11 në fushën e krimit të organizuar.

Ndërkohë deri në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2021 ka vazhduar gjykimi për 6 çështjet e mbartura nga viti 2020, 1 për korrupsion, 2 për krim të organizuar dhe 3 për vepra të tjera penale.

⁸ Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Çështja: 58110-00062-87-2021: Link: <http://ëëë.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/c%C3%ABshtjet-gjyq%C3%ABsore/c%C3%ABshtjet-penale/>



Grafik 2: Ecuria e statusit të çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Apelit KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Dimensioni II: Efiçenza




Gjatë periudhës 1 janar-qershor 2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë në total **48 vendime**, 30 prej të cilave i përkasin çështjeve të vitit 2020 dhe 18 prej të cilave i përkasin çështjeve të regjistruara në këtë gjykatë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021.⁹

Për të llogaritur kohëzgjatjen e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit, janë përfshirë data e regjistrimit të çështjes në gjykatë dhe data e shpalljes së vendimit. Intervali kohor i përdorur për vlerësimin e çështjeve përfshin segmentet kohore: **më pak se 1 muaj, 1-6 muaj, 7-12 muaj, 1-2 vjet dhe më shumë se 2 vjet.**

Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile në Nenin 399/2/d, afati i arsyeshëm i gjykimin të krimeve në gjykimin penal në shkallë të parë është **deri në 2 vjet** ndërsa përfundimi i gjykimin për krimet në gjykimin në apel është **1 vit.**

Siç evidentohet edhe në grafikun më poshtë pjesa më e madhe e çështjeve për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallë të parë, specifikisht 20 prej tyre kanë zgjatur brenda intervalit kohor prej 1-6 muaj, shqyrtimi gjyqësor për 12 prej tyre ka zgjatur në më pak se 1 muaj, ndërkohë për 9 çështje të tjera kohëzgjatja e gjykimin përfshihet në intervalin prej 7-12 muaj. Ndërkohë, gjykimi për dy prej çështjeve në fushën e krimit të organizuar ka tejkaluar periudhën prej 2 vitesh.



Grafik 3: Kohëzgjatja e çështjeve penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

⁹ Në kohën që ka përfunduar përgatitja e këtij Raporti Vlerësimi në ëeb faqen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë nuk mund të aksesohen të dhënat për 3 prej çështjeve (Çështje nr. 37, 7 dhe 29).


Çështje të korrupsionit

Nga vlerësimi i realizuar për **26 çështjet penale të korrupsionit** për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës kohore janar-qershor 2021, evidentohet që për 8 prej tyre gjykimi ka përfunduar për një periudhë kohore më pak se 1 muaj dhe për 16 të tjera gjykimi ka përfunduar për një periudhë kohore ndërmjet 1-6 muaj. Vetëm për 2 çështje për korrupsion gjykimi ka përfunduar brenda intervalit kohor prej 7-12 muaj.

Edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit gjykimi i çështjeve për korrupsion ka zgjatur më pak se 1 muaj. Dy vendimet e dhëna nga kjo gjykatë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 për këto çështje kanë zgjatur respektivisht 26 dhe 28 ditë.

Çështje të krimit të organizuar

Gjatë vitit 2020 kohëzgjatja e çështjeve penale në fushën e krimit të organizuar ishte më e gjatë krahasimisht me çështjet e tjera. Gjatë periudhës janar-qershor 2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka dhënë **14 vendime për çështje të krimit të organizuar** të regjistruar, 6 prej të cilave kanë zgjatur brenda intervalit kohor prej 7-12 muaj. Dy çështje kanë përfunduar në periudhën 1-2 vjet dhe 2 të tjera kanë tejkaluar periudhën e gjyqimit prej 2 vitesh. Vetëm për 1 çështje për krim të organizuar kohëzgjatja e gjyqimit ka zgjatur 86 ditë (1-6 muaj).



Grafik 4: Kohëzgjatja sipas llojit të çështjeve penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Dimensioni III: Relevanza




Çështje të korrupsionit - Veprat penale dhe Subjektet

Çështjet penale në fushën e korrupsionit përbëjnë numrin më të lartë të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës kohore janar-qershor 2021, prej **29 çështjesh** nga 49 në total.

Ashtu sikurse edhe për çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020, edhe në rastin e çështjeve të korrupsionit të regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021, kryesojnë akuzat penale të korrupsionit ndaj **personave që ushtrojnë funksione publike**. Edhe akuzat për **ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike** përbëjnë gjithashtu një numër të konsiderueshëm veprash penale të regjistruara.

Vetëm **1 çështje** penale për korrupsion aktiv të anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, rezulton të jetë regjistruar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021.

Asnjë çështje penale në fushën e korrupsionit e regjistruar gjatë kësaj periudhe nuk përfshin akuza për korrupsion kundrejt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë.



Grafik 5: Veprat penale sipas çështjeve për korrupsion të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Çështje të korrupsionit - Masat e dënimit¹⁰

Numri më i lartë i të pandehurve/akuzuarve në çështjet penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës janar-mars 2021 është **19** dhe përfshin vepra penale në fushën e korrupsionit. Për 17 çështjet e tjera të korrupsionit, numri i të pandehurve është: 1 në 9 prej çështjeve, 2 në 5 çështje dhe 3 në 2 çështje.

Nga **26 vendimet** e dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për çështje penale në fushën e korrupsionit të regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021, në vetëm 4 çështje është dhënë dënimi përfundimtar me burgim për 5 të pandehur. (Shiko Aneks A)

Gjithashtu në vendimet e dhëna gjatë kësaj periudhe nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për 3 të pandehur është vendosur **heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike** të pandehurit për periudha që variojnë nga 3 deri në 5 vjet.

Për pjesën më të madhe të çështjeve të korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë masat e ekzekutimit të dënimit me burgim janë zëvendësuar me **periudhë vënie në provë (për 20 të pandehur)**. Vendosja e kontakteve me shërbimet e provës dhe vënia në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, mund të vendoset nga gjykata duke marrë në konsideratë disa kushte të caktuara.

Këto kushte përfshijnë rrezikshmërinë e paktë të personit, moshën, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyrën së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së kësaj vepre. Ndërkohë detyrimet, të cilat i dënuari detyrohet të plotësojë nga gjykata parashikohen në nënin 60 të Kodit Penal.




Figura 3: Masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale të korrupsionit

(1 janar 2021 - 30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

¹⁰ Në kohën që ka përfunduar përgatitja e këtij Raporti Vlerësimi në ëeb faqen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë nuk është publikuar Dispozitivi i Vendimit për çështjet e korrupsionit nr.: 18, 21, 46, 53, 68 dhe 90. Masat e dënimit për këto vendime nuk janë reflektuar në këtë analizë.

Çështje të krimit të organizuar - Veprat penale dhe Personat e përfshirë


Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës janar-qershor 2021, **12 çështje penale** në fushën e krimit të organizuar, për 1 prej të cilave është përfunduar gjykimi (Vendim Nr. 34, datë 20.04.2021).

Veprat në fushën e narkotikëve dhe ato në kuadër të **organizatës kriminale** përbëjnë numrin kryesor të akuzave në çështjet penale në fushën e krimit të organizuar, ndërkohë që numri i të pandehurve në këto çështje rezulton të jetë i ulët. Në 5 prej tyre numri i të pandehurve është 1 dhe në 5 të tjera është 2.

Vrasja dhe vjedhja konsiderohet të jenë mënyrat kryesore të veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar për kryerjen e veprimtarisë kriminale, ndërkohë që **ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve** përbën një nga veprimtaritë kryesore kriminale, të ndërmarra për kryerjen e veprave penale në fushën e krimit të organizuar.

Megjithëse numri i çështjeve në fushën e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë është më i vogël krahasimisht me çështjet në fushën e korrupsionit, në analizën e 12 çështjeve të regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021 vërehen elementë të ngjashëm me ato të analizuar në çështjet në fushën e krimit të organizuar të regjistruara gjatë vitit 2020, të tilla veprimtaritë kriminale dhe modus operandi.

Një nga mangësitë në vlerësimin e çështjeve në fushën e krimit të organizuar mbetet shtrirja transnacionale e tij si edhe dëmi i shkaktuar në ekonominë e ligjshme.



Grafik 6: Numri i të pandehurve për çështjet e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKKO

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

3 – 5 persona të pandehur
5 – 10 persona të pandehur
> 10 persona të pandehur

Neni 28/4	Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale	1
Neni 284/a	Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale	
Neni 333	Organizata kriminale	1
Neni 333/1	Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale	
Neni 333/a	Grupi i strukturuar kriminal	2
Neni 333/a/1	Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale	6
Neni 333/a/2	Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal	7
Neni 334	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	3
Neni 334/1	Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal	7
Neni 334/2	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal / Kur dispozita përkatëse referuese përmban dënim me burgim apo me burgim të përjetshëm	

Tabela 2: Numri i të pandehurve në çështjet penale në fushën e krimin të organizuar, ku përfshihen vepra penale në kuadër të organizatave kriminale

(1 janar 2021-30 qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Çështje të tjera penale


Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës janar-qershor 2021 edhe **8 çështje** të cilat lidhen me akuza të tjera penale kundrejt subjekteve të parashikuara në kompetencë të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë **8 vendime** për këto çështje, 3 prej të cilave përfshijnë çështje të regjistruara në vitin 2020. Një nga këto vendime përfshin dënimin e dhënë nga kjo gjykatë për ish-Kryeprokurorin e Përgjithshëm me 2 vjet burgim si edhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike, për një periudhë prej 5 vjeçare.

Në 5 vendime të tjera Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur **moskompetencën lëndore** në lidhje me shqyrtimin e çështjeve. Të 5 këto çështje përfshijnë akuzat për shpifje dhe fyerje ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që për 3 prej tyre Gjykata e Posaçme ka vendosur gritjen përpara Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjeve dhe për 1 prej tyre është vendosur dërgimi i akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ajo çfarë evidentohet në rastin e veprave penale për 8 çështjet e regjistruara gjatë periudhës janar-qershor 2021 është numri i ulët i të pandehurve si edhe akuzuesi, i cili përveçse në 3 çështje të inicuar nga Prokuroria e Posaçme, në 5 rastet e tjera është **person juridik**.

Numrin më të madh të akuzave në këto çështje e përbëjnë veprat penale që lidhen me **shpifjen dhe fyerjen** si edhe **shpërdorimin e detyrës**, ndërkohë që vetëm 1 prej çështjeve përfshin akuza për falsifikim të dokumentave dhe shpërdorimit të detyrës.



Grafik 7: Vepra të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(1 Janar 2021 - 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

ANEKS A: Masat e dënimit të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale për korrupsionin për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallën e parë (1 Janar 2021 - 30 Qershor 2021)

Nr. i çështjes	Veprat penale	Baza ligjore dhe masa e dënimit	Masa e dënimit e kërkuar nga Prokuroria	Masa e dënimit e dhënë nga Gjykata
1.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh për të pandehurin për një afat prej 24 muaj, me kusht që të mbajë kontakte me shërbimin e provës të mos kryejë asnjë vepër penale tjetër.	Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përbushë një punë në interes publik, prej 60 orë , duke u kryer kjo punë brënda afatit prej 6 muajsh .
3.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim prej 7 muajsh për të pandehurin për një afat 3 vjet, me kusht që të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe gjatë kohës së provës të mos kryej asnjë vepër penale tjetër.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 6 muajsh dhe vënien në provë me afat 12 muaj .
	Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	Neni 291 10 ditë-3 vjet (Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.)		
7.	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 259 2-8 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh/8 muaj dhe vënien në provë e të pandehurit për një periudhë 4 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 3 vjetësh/4 muaj dhe vënien në provë e të pandehurit për një periudhë 5 vjet .
	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh dhe vënien në provë të tij për një periudhë 4 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 2 vjetësh dhe vënien në provë të tij për një periudhë 4 vjet .
	Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet	Neni 199/a/1 Gjobë ose burgim deri 1 vit		
12.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 12 mujore	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 8 mujore .
13.	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	4 muaj	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia e tij në provë për një periudhë 8 mujore .
23	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë	Neni 245/1/2 6 muaj – 4 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.	Miratimin e marrëveshjes datë 21/02/2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit prej 10 muajsh .

	ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara				
26	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit		Miratimin e marrëveshjes datë 17.03.2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe vënia në provë për një periudhë prej 1 vit e 2 muaj.
29	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	5 muaj		6 muaj
	Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	Neni 291 10 ditë-3 vjet (Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.)			
35	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh.		Miratimin e marrëveshjes datë 30.04.2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kthyer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh.
40 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 (25) 6 muaj-3 vjet	2 vjet/4 muaj	2 vjet/4 muaj	1 vit
	Prodhimi i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industrialë dhe ushqimorë kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda	Neni 288/a/2 3-10 vjet			
	Fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përlogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale	Neni 180/1 (25) Deri në 3 vjet			
61 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh.		Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh.

65 (Viti 2020)	"Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, personit që premtton ose siguron se është në gjendje të ushtrojë ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës dhe marrjen e vendimeve nga personat që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara"	Neni 245/1/1 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 9 muajsh , duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë prej 18 muaj.		Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 9 muajsh , duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë prej 18 muaj .	
	Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet	Neni 199/a/1 Gjobë ose burgim 1 vit				
	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	Neni 245/1/2 6 muaj – 4 vjet		1 vit		1 vit
84 (Viti 2020)	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	Neni 245/1/2 6 muaj – 4 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 10 muajsh dhe vënien në provë të të dënuarit për një afat 20 muaj.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 10 muajsh dhe vënien në provë të të dënuarit për një afat 20 muaj.	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 10 muajsh dhe vënien në provë të të dënuarit për një afat 20 muaj .	Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim prej 10 muajsh dhe vënien në provë të të dënuarit për një afat 20 muaj .
89 (Viti 2020)	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 259 2-8 vjet	2 vjet Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike të pandehurit për një periudhë prej 3 vjet.	2 vjet Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike të pandehurit për një periudhë prej 3 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur me burgim prej 2 vjetësh , duke e vendosur të pandehurin në një afat prove për një periudhë prej 4 vjet . Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike të pandehurit për një periudhë prej 5 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur me burgim prej 2 vjetësh , duke e vendosur të pandehurin në një afat prove për një periudhë prej 4 vjet . Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike të pandehurit për një periudhë prej 5 vjet.

91 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.	Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh .
92 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.	Miratimin e marrëveshjes për pranimit fajësisë. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh .
93 (Viti 2020)	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	Neni 245/1/2 6 muaj – 4 vjet	Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh , duke e vendosur në afat prove për një periudhë prej 2 vjet. Dënimi plotësues, heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike, për një periudhë prej 3 vjet.	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 6 muajsh , duke e vendosur të pandehurin në një afat prove për një periudhë prej 18 muaj . Heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike të pandehurit për një periudhë prej 3 vjet.
94 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.	Miratimin e marrëveshjes datë 30.12.2020 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe vënia në provë për një periudhë prej 1 vit e 2 muaj .
95 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh për një afat prej 24 muaj.	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia në provë për një periudhë 8 muaj .
96 (Viti 2020)	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh për një afat prej 24 muaj.	Pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim prej 4 muajsh dhe vënia në provë për kryerjen e një pune me interes publik, për një kohë prej 60 orë , brenda afatit prej 6 muajsh .

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes



[csdgalbania](#)



[csdgalbania](#)



[csdgalbania](#)